



Npi – 01/141 datë: 03.06.2021

Duke u bazuar në nenet: 12.2 pika (d), nenin 17, pikat (a dhe c) nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008) ; Nenin (4), (5), (6.1.2), (8.1.2), (15), (17), dhe (19) të Ligjit Nr. 06/L-092, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Nenin 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës; Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën komunale, Zona Kadastrale – Davidovc Npi – 01/275 datë: 24.11.2020; Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020; Si dhe në bazë të Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën Komunale në Zonën Kadastrale – Davidovc, Npi – 01/136 datë: 27.05.2021; Kuvendi Komunës, pasi analizoi edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN E PALUAJTSHME KOMUNALE NË ZONËN KADASTRALE – DAVIDOVÇ FIRMËS “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K.

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më 03.06.2021, unanimisht Aprovoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, në pjesën e Ngastres Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej: 6700m² (gjashtëdhjetë e shtatë ari) Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, i epen firmës “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K. Nr. i biznesit: 811565540, me përfaqësues Albnor Shehu, Adresa: Rr. “Ibrahim Rugova” p.n. Davidovc, E-mail: albnor.shehu@hotmail.com Tel. mob. 049-669-579. I cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar 429 ose 85.8% poena.

II

Sipërfaqja e tokës komunale që i është dhënë në shfrytëzimin me kompensim, për 99 vite, firmës “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K. Gjendet në fshatin Davidovc, Rr. “Ibrahim Rugova”: Ngastra Kadastrale: Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe prej: 6700m² (gjashtëdhjetë e shtatë ari), Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime.

III

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e planeve komunale si: Realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020; Strategjia e Zhvillimit Rural; Përkrahjen e bizneseve vendore; Rritjen e Punësimit dhe Investimeve, Shtimin e numrit të bizneseve, Zhvillimin Ekonomik, si dhe rritja e numrit të taksapaguesve për Komunën e Shtimes.

IV

Pas përfundimit të afatit prej 99 viteve, nga data 03.06.2021, prona i kthehet titullarit të pronës – Kuvendit të Komunës së Shtimes, më datën: 03.06.2120.

V

Sipërfaqja është e lejuar të shfrytëzohet vetëm për zhvillimin e biznesit që ka të bëjë me: Aktivitetin kryesor: Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjeteve, aktiviteti sekondar: Tregëtia me pakicë e pjesëve dhe aksesoreve të automjeteve, dhe aktivitete të tjera të parapara me Çertifikatën e Biznesit Nr. 811565540, të firmës “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K. në përputhje të plotë me legjislacionin dhe aktet tjera pozitive në Kosovë.

VI

Autorizohet Ekzekutivi i Komunës që, duke u bazuar në këtë vendim dhe aktet pozitive në Kosovë, të kryej punët gjeodezike për rexhistrimin e pronës, të hartojë kontratën për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të Komunës me firmën “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K. të përcjellë implementimin e investimeve prej: 1.043.095 euro, brenda dy viteve, punësimin e 27 puntorëve, si dhe pagesën vjetore të qirasë: 10 (dhjetë) euro për ari, të parapara me planin e biznesit të firmës. Si dhe të përcjellë implementimin e tërësishëm të këtij vendimi.

VII

Kuvendi i Komunës së Shtimes, rezervon të drejtën që në rast të dështimit të biznesit “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K. ose në rast të mos fillimit të aktiviteteve punuese, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve, të shkëputë kontratën njëanshëm dhe të anulojë këtë Vendim.

VIII

E drejta e fituar nga firma “AUTOCENTER A-GRUP” SH.P.K. për shfrytëzimin e pronës komunale, sipas dispozitivit të këtij vendimi nuk mund të shitet, trashëgohet, tjetërsohet ose bartet te personat e tretë, me ose pa kompenzim.

IX

Kuvendi i Komunës, kërkon nga Kryetari i Komunës, si përfaqësues Ligjor, që në hartimin e Kontratës përveç të tjerave të përfshihen edhe elementet e Planit të Biznesit të firmës, si dhe elementet e këtij Vendimi.

X

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

XI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahai